**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHIJAK**
**SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

**Shijak,më 29.06.2026**

**PROJEKT-VENDIM**

**"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.45 DATË 22.05.2020 'PËR MIRATIMIN E AKTEKSPERTIZAVE TE THELLUARA ME NIVEL DËMI DS4 SHEMBJE ' "**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pikat 3 e 8, 20, 21, pikat 3 e 4 , 22, pika 4, 23 pika 4, 25, pika 2 dhe 34, pika 6, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" , Vendimit Nr. 886, datë 30.12.2019, "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2019, per Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë , për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e qeverisjes vendore, të prekuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019", Kryetari i Bashkisë propozoi,

**PËR TË VENDOSUR:**

1.Miratimin e listes me 2 përfitues të kualifikuar, sipas ankesave të bëra nga aplikantet e dëmtuar për skualifikim nga termeti i datës 26.11.2019, si dhe pas vendimit të komisionit për kualifikimin e tyre sipas aktekpertizave të thelluara të ardhura nga Instituti i ndertimit të klasifikuara me shkallë dëmtueshmërie DS4 shembje dhe DS5 shembje.

2.Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit si njësi zbatuese dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Shijak, për zbatimin e këtij vendimi.

**Juriste**
**Albiona Mehmeti**

**Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit**
Jonida Goga

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
Kozeta Doda

**KRYETARI**
Elton Arbana

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHIJAK



Scanned with CamScanner